




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, info.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Procesverbal

I mbajtur në Seancën e katërt (IV) të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, më datë 26.5.2015 me këtë:

R E N D P U N E

- 1** Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar
- 2 Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**
 - 2.1 -Diskutim rreth Teatrit të Qytetit
 - 2.2 -Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve të Shoqatave dhe Klubeve sportive të Komunës së Gjilanit
 - 2.3 -Kompensimi i Komisionit për plotësimin e emërimit të rrugëve dhe numërimit të adresave për territorin e komunës së Gjilanit
 - 2.4 -Propozim vendimi për funksionalizimin e Komitetit për bashkëpunim ndërkufitar dhe Komitetit për Barazi Gjinore
 - 2.5 -Ndarja e mjeteve financiare për botimin e dorëshkrimeve letrare-publicistike të Beqir Musliut
 - 2.6 -Ndarja e mjeteve financiare për projektin e Festivalit "Gjilani 2015"
 - 2.7 -Rekomandim për Qeverinë e Kosovës (MPB) për nxjerrjen e UA për krijimin e lehtësirave për qytetarët e Kosovës Lindore

3 Të ndryshme

Seanca i filloi punimet në ora 10.15 min

Në punimet e Seancës së katërt (IV) morën pjesë:

Anëtarët e Kuvendit

Kryetari i Komunës, z. Lutfi Haziri

Drejtorët e drejtorive

Përfaqësuesi i OBS-së, Irfan Ukshini

Përfaqësuesi i të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Fazli Abdullahu
Përfaqësuesi i Shoqërisë Civile, z. Shaban Terziu
Disa aktorë të Teatrit të Gjilanit
Mediet

Seancën e katërt e hapi dhe udhëhoqi, kryesuesja e Kuvendit, zonja Valentinë Bunjaku –Rexhepi e cila fillimisht i përshëndeti anëtarët e Kuvendit, kryetarin e Komunës, z. Lutfi Haziri, dhe të gjithë të pranishmit e tjerë në punimet e kësaj seance.

Në fillim të punimeve kryesuesja kërkoi që të verifikohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit në punimet e seancës së katërt.

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar

Nga ana e sekretarisë u konstatua se në punimet e kësaj seance ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit (35).

Pasi që kishte kuorum të plotë për të vazhduar me punë, kryesuesja e hapi debatin përkitazi me rendin e punës.

Bujar Nevzadi- sa i përket rendit të punës, unë që disa herë kam kërkuar që në rend të punës të hyjnë edhe këto pika: Ndërtimet pa leje në Komunë të Gjilanit, mandej kam kërkuar debat për Shtëpinë e Kulturës në Përlepnice, gjithashtu kam kërkuar debat edhe për Pendën e Përlepnices, sepse ka dëmtime serioze dhe i tërë fshati gjendet para një rreziku katastrofal.

Mandej kërkoj për ta ditur se a iu janë krijuar kushtet procesmbajtësit të seancave, sepse në seancën e kaluar është ankuar për mungesë të këtyre kushteve. Mirëpo sa i përket procesit duhet ta dinë të gjithë se procesi i seancës nuk shkruhet fjalë për fjalë, por vetëm esenca e diskutimeve në mënyrë përmbajtjesore.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi –këto pika të rendit të punës në këtë seancë nuk mund të hyjnë në këtë seancë, por do t’i kemi parasysh për seancat e radhës.

Bujar Nevzadi- nuk qëndron ajo që unë këto pika të rendit të punës i kam kërkuar vetëm në seancën e fundit, sepse për Shtëpinë e Kulturës dhe Pendën në Përlepnice së paku në tri –katër seanca e kam ngrit këtë çështje.

Riad Rashiti- unë së pari kërkoj që të na informoni lidhur me panairin të cilin e keni pasur në Cyrih të Zvicrës, sepse duhet ta dimë se në çfarë niveli është përfaqësuar Komuna në atë panair? Duhet të na informoni se cilat projekte janë prezantuar në këtë panair nga KK e Gjilanit si mundësi për t’u investuar në Gjilan nga investitorët e ndryshëm. Mandej na intereson se çfarë kushte ka plotësuar Komuna e Gjilanit e cila e ka marrë një çmim në këtë panair, sepse për ne ky çmim është politik ose i blerë, sepse Komuna e Gjilanit asnjë investitor të jashtëm nuk e ka sjell dhe ne nuk e kemi të qartë se si është marrë ky çmim? Gjithashtu duhet dhënë edhe informacion se sa i ka kushtuar Komunës së Gjilanit, pjesëmarrja në këtë panair?

Mandej ne jemi të informuar se në Administratë të Gjilanit ka vështirësi për furnizim të printerëve dhe ngjyrës, sepse ende asnjë kompani nuk është kontraktuar për këtë qëllim.

Mandej kërkojmë informatë, se çka po ndodh me Lumin Mirusha, pse janë ndërprerë punët? Kur do të kompensohen shpronësimet nga dëmet që iu kanë shkaktuar qytetarëve gjatë realizimit të punëve. Pyetje e tretë ka të bëjë me vlerësimet e dëmeve nga vërshimet, sepse kërkojmë për ta ditur se a janë kompensuar dëmet nga vërshimet të cilat kanë ndodhur vitin e kaluar? Sipas informacioneve për kompensim të dëmeve janë premtuar 1.6 milion €, por gjatë vizitës së

kryeministrit në Gjilan, këtyre mjeteve iu është ndërruar destinimi dhe ato mjete do të shpenzohen për përmirësim të infrastrukturës në Gjilan?

Pyetja e fundit ka të bëjë përkitazi me Bordin e Kompanisë Publike “Kosovatrans” në të cilin bord ka kaluar një vit prej kur është i lirë një vend, por Komuna asnjëherë nuk ka shpall konkurs për këtë vend të lirë.

Shukrie Rapuca- unë do ta ngrit një problem përkitazi me Lagjen e Zabelit e të cilin problem e kam ngritur edhe më parë (edhe para 7-8 viteve). Lagjja e “Zabelit të Sahit Agës “ nuk ka qasje në rrugët publike edhe pse është një ndër lagjet më të vjetra të qytetit dhe ka një plan urbanistik që nga viti 1983, por një pjesë e kësaj lagjeje nuk e ka të zgjidhur problemin e infrastrukturës rrugore.

Është karakteristike se si kjo lagjeje është diskriminuar në këtë aspekt, por po vazhdon të diskriminohet edhe më tutje. Si shembull është se të gjitha rrugët dhe rrugicat e Lagjes “Arbëria” janë të asfaltuara, në pjesën ku fillon Lagjja e Zabelit, por gjithashtu edhe pjesa ku e ndan rrugën nga ish tregu i kafshëve në drejtim të Kuscës i kanë rrugët të definuara dhe të asfaltuara, por këto ditë janë duke u asfaltuar edhe rrugicat e fundit, por ndonjëherë edhe duke u riasfaltuar, kurse pjesa nga ana e djathtë jo që nuk janë asfaltuar, por shumica e rrugëve as që janë të definuara, gjegjësisht janë të bllokuara. Kështu qytetarët për shkak të rrethojave të cilat janë bërë me tel, qytetarët detyrohen të sillen për disa kilometra duke kaluar nëpër oborre të njëri tjetrit për t’ u qasur në rrugën publike !

Një problem në vete e paraqesin nxënësit, sepse për të ardhur në shkollë të Zabelit kanë shumë vështirësi dhe shpeshherë malltretohen bukur shpesh nga pronarët e tokave nëpër të cilat ata kalojnë në mungesë të rrugëve. Këtë problem Komuna mund ta zgjidh, sepse ende nuk është uzurpuar hapësirat ku janë të parapara rrugët sipas planit urbanistik.

Gjithashtu pronarët e tokave ku kalojnë rrugët janë të pajtimit që ta japin sipërfaqen e nevojshme, por ata kërkojnë kompensim dhe në pyetje janë pak para të cilat për Komunën nuk paraqesin kurrfarë problemi.

Unë po theksoj se disa herë e kam ngritur këtë problem edhe në mandatin e kaluar, por nuk kam hasur në mirëkuptim dhe me plotë të drejtë po theksoj se nuk ka asnjë rast qoftë edhe në fshatrat më të largëta të Komunës sikurse rasti i Zabelit që është në zemër të qytetit.

Në fund po theksoj se qytetarët e zabelit janë duke e humbur durimin dhe një ditë do të vijnë në Komunë dhe do të bllokojnë institucionet komunale derisa problemi i tyre të zgjidhet!

Fehmi Sylejmani- unë po përsëris disa kërkesa, sepse në seanca nuk po marrim përgjigje, ose po e marrim ndonjë përgjigje në mënyrë periferike. Unë kam pyetje nga qytetarët e “Dardanisë” se kur do të fillojë projekti shumë i proklamuar ? Ne nuk e dimë se ku gjendemi me këtë projekt, a kanë filluar procedurat e tenderimit dhe kur do të fillojë ky projekt?

Gjithashtu në seancën e kaluar drejtori i Shërbimeve Publike ka premtuar se në Sheshin “Xhavit Ahmeti” do të merren masa për ta pastruar atë shesh, sepse ai shesh është degraduar në tërësi.

LDK-së i takon që ta ketë një shesh të cilit do t’ i lakmojnë të gjithë, sepse ky shesh e mban emrin e një njeri me reputacion të madh kombëtar.

Kërkesa tjetër është lidhur me sektorin tatimit në pronë i cili sektor është në katin e dytë, por nuk e di se a është menduar se në atë sektor do të shkojnë edhe personat e hendikepuar? Pyetje është si do të shkojnë këta persona (të hendikepuarit) në katin e dytë?

Si kërkesë e katërt është që drejtori i Arsimit të na jep një informatë për testin e arritshmërisë për nxënësit e klasës së nëntë. Mirëpo kërkojmë edhe informatë për testin e maturës, se deri në cilin nivel ka rritur përgatitjet për këtë test sa i përket Drejtorisë së Arsimit ?

Avdyl Aliu- lidhur me diskutimin e koleges Rapuca, deshta t’ i them disa fjalë, sepse edhe unë jam nga lagja e “Zabelit të Sahit Agës” . Mua më vjen mirë që zonja në fjalë tash ka filluar të mendojë diçka për Zabel, por më vjen keq që për 6 vite sa kanë qenë në pushtet nuk e kanë bërë asnjë punë më të vogël për Zabelin. Për 6 vjet asnjë kanalizim nuk është kryer, asnjë lopatë asfalt nuk është

hedhë dhe asnjë punë tjetër nuk është kryer në Zabel! Po e them me përgjegjësi të plotë se asnjë cent investime për 6 vite nuk është bërë në Zabel.!

Mirëpo që në vitin e parë të kësaj qeverisje janë investuar mbi gjysmë milion € në Zabel. Janë 8 rrugë në asfaltim e sipër, disa kanë përfunduar dhe disa janë në asfaltim e sipër. Gjithashtu është duke u realizuar projekti i kanalizimit, projekti i trotuarit, por jemi duke i identifikuar edhe problemet e tjera. Unë pajtohem me zonjën Rapuca se ka edhe shumë probleme të pazgjidhura, por vazhdimisht po punohet në atë drejtim.

Izmi Zeka- është e ditur se opozita kur i bën kërkesat, ato ia bënë Qeverisë Komunale. Mirëpo duhet ta dini se ne tash nuk jemi në fushatë parazgjedhore? Nuk ka nevojë tash të flitet se çka është bërë para 6-7, sepse kjo është harruar, sepse është një shkollë mjaft e mirë në Zabel, por po i përmendi se diku janë 100 milion € investime për ato 6-7 vite.

Mirëpo unë kërkoj nga kryetari Haziri që në seancën e radhës të na i sjell projektet të cilat i ka paraparë për këtë vit? Të na japin informata dhe ta dimë ne si anëtarë të Kuvendit dhe mos të merremi me fjalë të çarshisë. Ne e kemi aprovuar buxhetin, por gjërat nuk janë në detale, por iu lus që anëtarët e Kuvendit mos të na mbajnë “ders”. Ne po i drejtohem Qeverisë Komunale dhe jo anëtarët e KK-së të hyjnë në debate në mes vete.

Zabeli nuk është njollë e zezë e Qeverisë së kaluar! Mirëpo ju e keni pushtetin, punoni dhe ne do t’iu përkrahim dhe nëse ne nuk kemi bërë diçka mirë, urdhëroni bëni riparime, përmirësoni gjërat, përkrahjen do ta keni! Ne dy mandate i kemi fituar me punë, kurse të tretin e keni fituar ju, prandaj ecni përpara, punoni!

Gjithashtu i lus anëtarët e Kuvendit që mos të flasin për lagje dhe mëhallë të veta, sepse ne jemi përfaqësues të nivelit komunal, prandaj duhet parë gjërat më gjerë.

Mua më internojnë ndërtimet pa leje! Një qytet është i njoftuar se ka ndërtime pa leje! Duhet të na i sillni të dhënat se cili objekt nuk ka leje dhe arsyen pse nuk ka leje?

Po e theksoj edhe njëherë se përkrahjen tonë do ta keni për aq sa gjërat janë konkrete të dobishme dhe në interes të Komunës së Gjilanit.

Kolegu i ynë z. Bujari kërkon që të sillet lista e ndërtimeve pa leje edhe atë në 3-4 seancat e kaluara, por askush nuk e merr mundin për të i sjell këto të dhëna në Kuvend dhe vazhdimisht na thuhet se do t’i sjellim në seancën e radhës.

Unë e kam një kërkesë për drejtorin e Arsimit? Drejtori duhet t’i ruajë raporte me mësimdhënësit dhe koleget. Mënyrën dhe qasjen e komunikimi po i them drejtorit se duhet ta ndërrojë? Ka informacione nga mësimdhënësit se mënyra e komunikimit të drejtorit nuk është korrekte!

Në fund kërkesa e ime është që në seancën e radhës të na sillen informatat se çfarë projekte planifikohen për vitin 2015? Sa i përket procesverbalit e theksoi Bujari se duhet bërë një ekstrakt të vogël në formë përmbajtësore dhe jo të shkruhet i tërë diskutimi. Është mirë që të marrim një qëndrim që mos të bëhet zhurmë dhe të thuhet se unë e kam thënë edhe këtë ose atë fjalë.

Shukrie Rapuca- të nderuar anëtarë të Kuvendit shumica prej juve më njihni mirë se kur e marrë për obligim për ta shtruar një problem, sa pak merrem me politikë? I nderuar i anëtari i Kuvendit nga lagjja e ime dhe anëtar i partisë sime, sa herë që e kam marrë fjalën është thënë se është lagjja e ime. Unë jam gëzuar shumë për të gjitha lagjet e qytetit, sepse jetoj në një periudhë prej 30 viteve në këtë qytet. Jam banore e lagjes së “Zabelit të Sahit Agës” e cila lagje është e qytetit tonë. Disa koleg në vend se të më përkrahin dhe të thonë mos e përsërit këtë problematik që 7-8 vite tani dalin edhe kritikën se po flas për lagjen time. A ka koment kjo kur e thash se nga tri katër orë policia rrinë në rrugën ku është e përfshirë gati gjysma e Zabelit. Nuk ka nevojë ta zgjas më tepër, sepse po të flas më tepër vetëm do të humb interesimi i të gjithëve.

Leonorë Bunjaku- është fundi i vitit shkollor dhe nuk e kemi paraparë asnjë pikë të rendit të punës sa i përket arsimit. Unë i kam dy pyetje e të cilat do t’i parashtroj në fund nëse drejtori i Arsimit

do të jetë i pranishëm deri në fund të seancës. Këto pika kanë të bëjnë me trajnimin e vazhdueshëm të mësimeve për avancim në mësime, por këtë çështje do ta parashtroj nën të ndryshme.

Arben Maliqi- unë i kam dy çështje për t' i ngrit e të cilat për mua janë mjaft të rëndësishme.

Një është testi i arritshmërisë e për të cilin test unë kam qenë kundër, sepse ky nuk është test i arritshmërisë, por është test i aftësisë. Këtë e kam thënë që nga fillimi, por tash jemi edhe në fund të përgatitjes së testit të maturës. Testin e maturës e kam përmendur shumë herë, sepse ka qenë skandaloz, sepse janë sjell njerëzit me prejardhje të dyshimta për t' i monitoruar nxënësit e që ka qenë një skandal. Mirëpo përsëri po i sjellën profesorët për ta monitoruar dhe për mua kjo është një jo seriozitet jashtëzakonisht i madh dhe të dihet se ky nuk është test i maturës, por është test i gjindshmërisë ! Unë apeloj që Ministria të mos i mbajë këto teste, sepse këto janë teste të mashtimit. Ne me këtë test po i mashtrojmë nxënësit dhe në këtë mënyrë po përfitojnë ata nxënës të cilët nuk kanë lidhje me mësim!

Nuk pati debatues të tjerë përkitazi me rendin e punës, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet rendi i punës?

Aprovohet rendi i punës me 27 vota të anëtarëve të Kuvendit, 7 ishin kundër, kurse të tjerët abstenuan.

Procesverbali aprovohet pa vërejtje me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit?

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

2.1. Diskutim rreth Teatrit të Qytetit

Avdyl Aliu- duke qenë zemër gjerë dhe transparent e kemi funt këtë pikë të rendit të punës për debat rreth Teatrit të Qytetit edhe pse ndoshta nuk ka pasur nevojë, sepse punët janë duke vazhduar në këtë drejtim. Puna në Teatër është duke u bërë edhe para se t' i bijë ndërmend dikujt se në Teatër ka probleme. Sikur dhe në çdo sektor edhe në teatër jemi duke u marrë me riparime nga prishjet të cilat janë bërë edhe më herët. Aq shumë janë gjet anomali në teatër sa që na është deshtë kohë e gjatë për t' i përmirësuar disa gjëra. Jam i bindur se së shpejti do të gjendet zgjidhja ligjore dhe një zgjidhje e qëndrueshme për Teatrin. Me këtë zgjidhje do t' i japim mundësinë artistëve që me ndihmën e tyre, por edhe me ndihmën tonë ta mbajmë të gjallë këtë teatër, por edhe ta zhvillojmë edhe më tutje në mënyrë që Teatri i Gjilanit të jetë shembull edhe për komunat e tjera.

Ky Teatër ende funksionon në bazë të Statutit për Teatrin Profesionist të vitit 2011, por menjëherë pas aprovimit të Ligjit për teatrot 042/106 nga Kuvendi i Kosovës në korrik të vitit 2012 ka qenë obligim i komunave që ta harmonizojnë statutin për teatrot menjëherë sipas Ligjit të cekur. Një harmonizim i tillë nuk ka ndodhur, prandaj jemi në këtë gjendje në të cilën gjendemi sot.

Ky ligj është një mundësi e mirë për ta forcuar dhe aktivizuar teatrin, sepse ky ligj e ka paraparë strukturën drejtuese të teatrit e cila strukturë nëse funksionon si duhet dhe nëse i kryen kompetencat dhe përgjegjësitë ashtu siç përshkruhet në ligj, patjetër se do të del një punë e mirë. E inkurojmë kryetarin dhe ekipin e tij që ta funksionalizojë këtë ligj si është më së miri.

Sahit Abazi- së pari e përshëndes komunitetin e aktorëve të cilët gjenden në këtë seancë, por i përshëndes edhe shëfkat e grupeve të cilët u pajtuan me iniciativën tonë që të debatohet në Kuvend për gjendjen në teatër. Qëllimi i jonë nuk është vetëm debati, por qëllimi është që të bëhet një zgjidhje në teatër e cila për fat të keq është shumë e rëndë, sepse Gjilani rrezikon që të mbetet pa teatër. Teatri nuk është i aktorëve as i regjisorëve, por është i qytetit. Problemi aktual është se qyteti i Gjilanit rrezikon që të mbetet pa një eveniment i cili është shumë i rëndësishëm, sidomos për brezat që do të vijnë. Ne kemi pasur mundësi që të bëjmë më shumë për teatrin, ta bëjmë një ndërkombëtarizim, sepse dihet se “Flaka e Janarit” është një nga bazat themelore të teatrit.

Një qytet në Kosovë ka arrit që ta ndërkombëtarizoj një festival e që është fjala për “Doku festin”, kurse në një festival që e organizojmë prej vitesh nuk kemi arrit që ai t’ i tejkaloj përmasat kombëtare.

Unë i kam vetëm dy- tri çështje për t’ ia thënë edhe shefit të grupit të LDK-së dhe të tjerëve se nuk mund të flasim për qeverisjen e kaluar kur kanë kaluar 18 muaj të qeverisjes aktuale dhe nuk janë pak 18 muaj qeverisje, kurse ende flitet për qeverisjen e kaluar. Gjendja në teatër nuk mund të politizohet, por gjendja në teatër vetëm duhet të zgjidhet. Çështja e teatrit është mjaft sfiduese, por duhet filluar nga një pikë për ta bërë zgjidhjen. Është filluar me borde, por nuk ka pasur rezultate dhe tash është një gjendje e papranueshme dhe kemi pasur një gjendje para organizmit të protestave. Aktorët që 6 muaj janë pa paga, ka pasur ndërprerje të reprizave të një shfaqje kulminante për shkak të mungesës së fondeve dhe trajtimit të teatrit.

Në teatër kemi njerëz të cilët e kanë lënë shëndetin, prandaj një trajtim i mirë i Komunës për këta njerëz është i domosdoshëm. Zgjidhjen duhet ta bëjmë sipas Ligjit për teatrot në Kosovë dhe komunat duhet të kujdesen për financimin e teatrove. Komuna duhet të ndaj fonde, sepse edhe kështu ka qenë premtimi i kryetarit kur i kemi bërë ndryshimet në statut se do të kemi njësitë e veçanta dhe do t’ i kenë fondet e veta, por kjo nuk ka ndodhur.

Unë jam i mendimit se duhet ta themelojmë një fond emergjent për teatrin për mos ta lejuar shuarjen e tij dhe duhet ta gjejmë mënyrën më të mirë dhe më të shpejt për t’ i paguar pagat e mbetura.

Mandej është propozim i joni dhe të hidhet në votim që të themelohet një fond nëpërmes të cilit parashihet që të ketë paga për punonjësit e teatrit 17-18 aktorë dhe për stafin teknik, por të ndahet fond edhe për 4 shfaqje dhe plus një për fëmijë.

Nuk mund të vazhdohet kohë të gjatë me fonde, por duhet bërë zgjidhje institucionale, sepse nuk mund të vazhdohet pafundësisht me këtë zgjidhje që është sot duke ndarë fonde vit për vit, por duhet të ekzistojë fondi i veçantë për teatrin.

Propozim i jonë është që të themelohet një fond emergjent për t’ ia dhënë pagat aktorëve dhe stafit teknik të teatrit për 6 muajt e kaluar, por të jetë edhe një linjë e veçantë për ta financuar dhe pjesën e pagave edhe 5 projektet të cilat janë të domosdoshme për një teatër.

Gjithashtu edhe “Flakën e Janarit” mund ta bëjmë në përmasat e “Doku festit” i cili festival ka edhe karakter komercial për qytetin e Prizrenit.

Selami Xhemajli- është mirë që është shtruar për debat gjendja në teatër, sepse nga një institucioni i cili ka qenë model për teatrot tjera në Kosovë dhe rajon, tash ka ardhur deri në këtë gjendje të rëndë, sepse nuk marrin paga aktorët dhe stafi teknik. Sipas mendimit tonë duhet bërë një zgjidhje, por ajo zgjidhje duhet të bëhet sipas Ligjit për teatrot i aprovuar në vitin 2012.

Statuti aktual i teatrit është Teatri i Gjilanit, por statuti i teatrit duhet të rregullohet në bazë të ligjit dhe të harmonizohet në bazë të këtij ligji.

Si alternative e dytë është që Këshilli Drejtues i teatrit, duhet t’ i bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për ta rikthyer statusin e Teatrit Kombëtar. Ky teatër i qytetit me kapacitet që i ka, me njerëzit që i ka mund të jetë teatër kombëtar, kurse Komuna do ta merrte një pjesë të barrës për ta ndihmuar teatrin. Mirëpo ne si KK sa më shpejtë duhet gjetur një zgjidhje emergjente për kryerjen e obligimeve ndaj aktorëve dhe stafit teknik të teatrit. Derisa nuk bëhet ndonjë zgjidhje përfundimtare sipas ligjit për teatrot, ne propozojmë që sa më parë të bëhet një zgjidhje emergjente për të mos i lënë edhe më tutje aktorët pa paga dhe për të vazhduar teatri me punë dhe aktivitete të tij.

Nevzad Isufi- në këtë pikë të rendit të punës po flasim për një temë shumë problematike e cila po zgjat në dy mandate të qeverisjes dhe më tepër. Po flasim për një teatër i cili i ka më shumë se 60 vjet ekzistencë, punë dhe aktivitete. Teatri i Gjilanit edhe në kohët më të rënda nuk e ka ndaluar punën dhe nuk pasur krizë sikur kanë pasur teatrot e tjera, prandaj jo vetëm për hir të aktorëve, por edhe për hir të qytetit dhe artdashësve nuk duhet ta lëmë në këtë gjendje teatrin sikurse është tash.

Se ka vullnet për punë është dëshmuar se aktorët kanë punuar dhe kanë dhënë shfaqje deri në muajin mars edhe përkundër asaj që nuk janë paguar një kohë të gjatë. Mirëpo edhe niveli i pagave të cilat i kanë marrë nuk e kalojnë mesataren e rrogës në Kosovë.

Unë mendoj se çështjet ligjore nuk janë pengesë, por u tha që kemi mosharmonizim të Ligjit për teatrin me Statutin e teatrit e të cilat unë i kam lexuar me kujdes e të cilat plotësisht janë në harmoni, sepse para ligjit ka qenë një projekt ligj i cili ligj është bërë në maj, kurse statuti në prill e që dëshmon se janë në harmoni, Statuti i cili është aprovuar në këtë Kuvend është mbështet në projekt ligjin dhe faktikisht nuk ka ndryshime. Unë mendoj se nuk duhet lënë në mëshirën e askujt teatrin, por ai duhet të funksionojë në bazë të ligjit dhe nuk duhet lënë në mëshirën e një sekretari se a do ta financojë një projekt apo jo? Çështja e parë dhe e rëndësishme është vetëm të mbështetemi në ligj dhe ta zbatojmë ligjin dhe teatri me siguri se do të funksionojë.

Në teatër janë disa çështje që mund të lëvizin dhe mund të thuhet se numri aktorëve është më i madh ose më i vogël, por janë disa çështje të cilat nuk lëvizin, sepse nuk mund ta bëjmë teatrin që të funksionojë sipas periudhave, për një periudhë të pushojë, kurse në periudhën tjetër përsëri të fillojë punën. Puna e teatrit duhet të jetë e përhershme, sepse ne shpesh po themi se përfaqësuesit e sportit dhe kulturës janë ambasador të tanë. Nëse është kështu, atëherë bëhet pyetje ku është ai investimi i ynë për këta ambasadorë? Mirëpo jam i mendimit se edhe salla e teatrit nuk po shfrytëzohet sa duhet, sepse po të shfrytëzohej mirë dhe të bëhen pagesa për takime të ndryshme do të jetë një mundësi për ta ndihmuar teatrin.

Ne mendojmë se me këtë status që ka teatri duhet të mendohet mënyra se si do të bëhet një financim i përhershëm i këtyre aktorëve, prej të cilëve disa punojnë me dekada të tëra në teatër. Nuk duhet lënë këtë njerëz në këtë gjendje duke i bërë zgjidhje të kohëpaskohshme, por duhet gjetur në zgjidhje të përhershme.

Ismet Hajdini- problemi i Teatrit të Gjilanit nuk është problem i kësaj qeverisje, por as i qeverisje së mëparshme, por është problem i një kohe më të gjatë (prej periudhës së pas luftës). Teatri i Gjilanit ka një traditë 70 vjeçare dhe ka qenë një ndër teatrot më njohura jo vetëm në Kosovë, por edhe në ish Jugosllavi, sepse ka marrë shumë çmime brenda ish këtij shteti (Kullë, Trebinje) etj. Është për keqardhje që pas këtyre sukseseve, teatri i Gjilanit të vijë në një gjendje të tillë.

Unë mendoj se teatrit të Gjilanit nuk duhet bërë zgjidhje ad hoc ose zgjidhje të përkohshme, por duhet bërë një zgjidhje afatgjate dhe kjo zgjidhje bëhet duke ia kthyer teatrit statusin e Teatrit Profesionist ashtu si e ka pasur. Në këtë mënyrë ne kemi arsyeje si Komunë ta kërkojmë nga Qeveria kthimin e atij statusi. Pas kthimit të statusit të Teatrit Profesionist, mund të gjenden shumë mënyrë për financim sipas projekteve të ndryshme, duke i financuar nga ambasadat e ndryshme, por edhe OJQ-të. Zgjidhja e vetme është kthimi i statusit të tetarit në Teatër Profesionist, por e përkrahi edhe mendimin se teatri nuk duhet të politizohet.

Shpresë Kurteshi- gjendja në teatër është shqetësuese për të gjithë neve, por kjo gjendje nuk është krijuar në kohë të fundit, por është një vazhdimësi e së kaluarës. Mirëpo kur i referohem së kaluarës nuk e kam për qëllim që ta akuzoj qeverisjen e kaluar, por po shprehi një shqetësim me këtë situatë të krijuar. Unë e di se institucione komunale kanë bërë maksimumin që brenda mundësive ligjore ta ndihmojnë teatrin dhe të del teatri prej kësaj gjendje në të cilën gjendet. Mirëpo për të bërë një zgjidhje më afatgjate duhet vepruar sipas rendit kronologjik. Ajo që duhet vepruar është që Këshilli Drejtues i Teatrit në bashkëpunim me Zyrën Ligjore duhet të bëjnë përpjekje për hartim të statutit të ri të teatrit dhe duhet kthyer statusin e teatrit të qyteti në teatër profesionist, kurse zgjidhje emergjente duhet bërë aq sa mundëson dhe lejon ligji.

Riad Rashiti- unë fillimisht nuk po kuptoj në këtë seancë se teatri a ka problem me ligjin (statusin), apo ka problem me çështje financiare? Unë dëgjova shumë diskutime, se duhet zbatuar ligjin, ose ndërruar statutin, por me sa e di unë statuti i teatrit është statut i teatrit profesionist (Teatri i Gjilanit). Në këtë seancë është prezent drejtori i teatrit i cili fillimisht ka qenë e rendit që ai ta

prezantojë gjendjen në teatër, sepse në raportin e punës nuk është raportuar për të arriturat ose ngecjet e këtij institucioni kulturor. Drejtori ka qenë desh ta paraqes problemin aktual në teatër, por problemin jo politik. Ne e dimë se teatrin e ka menaxhuar Ministria e Kulturës, por është kthyer përsëri në menaxhim të komunës, prandaj drejtori duhet të na jep sqarime pse është kthyer dhe kur është kthyer në menaxhim të Komunës. I tërë debati që po bëhet sot duke theksuar çështje ligjore ose statusin, mendoj se nuk qëndrojnë, por problemi kryesor është mungesa e vullnetit të kësaj qeverisje për t' i mbështet projektet dhe financimin e Teatrit të Gjilanit. U tha se ky problem është i bartur, por ne e kemi menaxhuar teatrin për 6 vite dhe mbi 120 mijë € janë ndarë për aktorët dhe aktorët nuk e kanë pasur këtë gjendje çfarë e kanë sot.

Ne e dimë se Gjilani i ka pasur dy ministra të Kulturës, por edhe në atë kohë teatri nuk ka qenë në gjendje më të mirë, sepse nuk është përkrahur edhe kur kanë qenë dy ministra të kulturës. Edhe sot nuk ekziston vullneti për ta përkrahur teatrin, por është mirë që ky vullnet të ndryshojë dhe të merren parasysh propozimet e z. Sahiti që të krijohet një fond emergjent për dalje nga kriza të teatrit.

Arben Maliqi- në Teatër është një problem i cili nuk është krijuar tash, por u tha se ky problem ekziston me dekada. Unë mendoj se këtë çështje duhet ta marrim shumë seriozisht dhe statusi i këtij teatri duhet të jetë i përhershëm. Teatri nuk mbahet me subvencione, prandaj jam i mendimit që teatri duhet ta ketë një status të përhershëm ashtu siç i ka hije. Unë mendoj se kryetari i Komunës duhet të bëjë përpjekje dhe teatri duhet të kalojë nën menaxhimin e Ministrisë së Kulturës dhe Sportit dhe kjo është zgjidhja më e mirë.

Ramadan Kurti- z. Kurti në cilësinë e aktorit të teatrit, para anëtarëve të Kuvendit paraqiti një kronologji të punës dhe aktiviteti të teatrit qysh nga themelimi e deri më sot. Mirëpo në fund të fjalës së tij propozoi që çështja e teatrit të zgjidhet në mënyrë institucionale, sepse kjo është e vetmja mënyrë për të dal nga kriza që ekziston në teatër.

Gyner Halili- z. Halili në cilësinë e aktorit të teatrit, para anëtarëve të Kuvendit e sqaroi problematikën e funksionimit të teatrit, por edhe propozoi mënyrën e zgjidhjes së problemit të teatrit duke kërkuar që të bëhet zgjidhje përfundimtare në mënyrë institucionale.

Lufti Haziri- mua më vjen mirë që KK ka filluar të diskutojë për tema të veçanta, por në fund po nxjerr edhe rekomandime. Mirëpo unë iu lus që çdo gjë që vendosni duhet të jetë në pajtim me ligjin. Nëse ne e zbatojmë ligjin për teatro tërë atë që e tha z. Kurti e tëra është në kundërshtim me ligjin atë që kërkoi sot. Ne jemi duke e vazhduar në teatër mënyrën e vjetër të menaxhimit dhe subvencionimit duke dëshiruar për ta zgjidh problemin paralelisht, por pa shkaktuar dridhje dhe pa shkaktuar telashe. Rruga të cilën e presim ndoshta është e gjatë, por vitin e kaluar nuk ka pasur autoritet në qeveri për ta ndihmuar teatrin. Në këtë vit po punojmë për ta ndihmuar teatrin, sepse Gjilani e ka humbur statusin në momentin kur është votuar ligji për teatrot. Ligji nuk thotë për ta paguar askënd duke qëndruar në kafe dhe nuk ka ligj që thotë për t' i dhënë pagën dikujt duke qëndruar tërë ditën nëpër kafe. Ligji teatrin e Gjilanit e trajton si Teatër Komunal, por pse ka ardhur deri te kjo ju e dini shumë mirë dhe kjo ka ardhur për shkak të ndërrimit të menaxhmentit. Një përplasje në mes Komunës dhe Ministrisë së Kulturës për ndërrimin e menaxhmentit, atëherë është proceduar ndryshimi i nenit i cili ia kthen të drejtën komunave për ndërrimin e menaxhmentit duke ia lënë “ këmbët e arushës në dorë”, sepse edhe buxhetin ia ka marrë. Kjo nuk është bërë me ndryshim të ligjit, por është bërë me ndryshim të një neni në seancë të Qeverisë.

Unë jam për ta zgjidhur statusin e teatrit në shkallën e parë dhe e vetmja mënyrë është që teatrin ta financojmë sipas nën kodit buxhetor, sepse nuk ka rrugë tjetër, nuk ka paga. Aktorët nuk janë shërbues civil, sepse ligji i trajton përformues kulturor. Aktorët nuk mund të hyjnë në listën e shërbimit civil, por menaxheri i teatrit është shërbues civil i cili menaxhon me teatrin e qytetit, kurse aktorët janë përformues kulturor që hyjnë në kategori të veçantë dhe njihen si punonjës të shtetit.

Zgjidhja nuk mund të bëhet me prerje, sepse ne mund të ndajmë buxhet, por mënyra e njëjtë e menaxhimit të mjeteve nuk do të jetë. Teatri duhet të menaxhojë me mjetet e veta, duhet të menaxhojë me kalendarin e vetë, duhet ‘ i shfrytëzojë hapësirat dhe duhet t’ i komercializojë një pjesë të hapësirave. Unë as një faturë deri më sot nuk e kam marrë nga menaxhmenti dhe nuk është thënë se Komuna ka mbajtur akademi përkujtimore dhe duhet të paguhet 280 €. Nëse jemi të liruar nga akademitë përkujtimore, nga aktiviteti komercial nuk jemi të liruar. Nuk po e fajësoj menaxherin, sepse ka bërë përpjekje maksimale për të gjet zgjidhje, por zgjidhja është në mes neve, Ministrisë së Kulturës dhe teatrit, sepse duhet punuar së bashku. Tendanca për të aktruar para anëtarëve të Kuvendit, unë e shoh si tendencë për mos i dhënë pozivitete zgjidhjes, por zgjidhja do të ndodhë deshti apo nuk deshti dikush!

Premtimi im ka qenë që statusin e teatrit do ta rikthejmë dhe financimin duhet ta bëjmë me nën kod buxhetor. Nën kodi buxhetor nënkupton sikurse e merr një pagë në janar si Drejtorja për urbanizëm dhe mandej në ato kushte dhe parametra punon, por llogari duhet të jap për mjetet e harxhuara sikur çdo organizatë tjetër. Kjo është zgjidhja e vetme dhe më vjen mirë që anëtarët e Kuvendit po e trajtojnë problemin me dinjitet.

Sahit Abazi- shihet një solidaritet i të gjithëve me aktorët e teatrit, mirëpo z. kryetar problemin e kemi për atë që ka ndodhur deri më sot. Nëse është zgjidhje që teatri të kthehet nën menaxhim të Ministrisë, ne mendojmë se është një zgjidhje e mirë. Mirëpo problemi është se ky komunitet i njerëzve është në gjendje të keqe, sepse e kanë problemin e pagave i cili është problem institucional. Ka raste të punëtorëve të teatrit (stafit teknik) që iu është ndërpre rryma dhe nga kjo shihet se kanë probleme ekzistenciale.

Ideja e jonë si grup i PDK-së është që të bëhet një zgjidhje emergjente për këtë periudhë, kurse në vijim t’ i epet hapësirë ministrisë që Teatri i Gjilanit të kthehet në Teatër Kombëtar. Është lajm i mirë që aktorët të paguhet në bazë të shfaqjeve, por problemi është që deri atëherë si të veprojmë?

Naser Zymberi- z. Zymberi në cilësinë e aktorit të teatrit, para anëtarëve të Kuvendit i paraqiti pikëpamjet e tij dhe propozimet për dalje nga kriza.

Lutfi Haziri- unë jam takuar me të gjitha strukturat të cilat i takojnë teatrit dhe saktë i njoh problemet brenda teatrit. Duhet kuptuar një çështje që Ansambli i Teatrit të qytetit të Gjilanit duhet të funksionalizohet dhe duhet të trajtohet me ligj, kjo është rruga. Ligjit aktualisht nuk e njeh këtë drejtë, sepse vetëm ansamblet kombëtare i njeh (teatrot kombëtare). Ne po bëjmë rrugë që ta bëjmë teatrin funksional të pranueshëm me ligj, prandaj duhet ta kuptoni drejtë se kjo është rruga nëpër të cilën do të kalojmë. Unë nuk e kam atë mundësi ligjore për ta bartur fondin dhe për të thënë kaq mundësi kemi. Për shfaqje po iu siguroj dhe çdo shfaqje që e vlerëson masa, Teatri i Gjilanit do të subvencionohet dhe ato mjete i epen aktorëve dhe askujt tjetër. Ne po sillemi këtu sikur gjëja vetëm një vendim po na duhet dhe po e kalojmë situatën, por nuk është kështu? Ne duhet të bëjmë përpjekje deri në zgjidhje përfundimtare ligjore për teatrin.. Unë jam për një zgjidhje çfarëdo qoftë ajo deri në zgjidhje ligjore, mjetet do t’ i marrin, por duhet ta dinë se nuk janë rroga dhe nuk ka listë të rrogave.

Riad Rashiti- unë gjatë tërë kohës e pash se ka një mospajtim në mes të kërkesave të aktorëve dhe të politikës së kryetarit për kulturën dhe teatrin në Gjilan. Unë i kuptoj sfidat që i tha kryetari sa i përket edhe ligjit edhe aspektit financiar. Mirëpo unë mendoj, por e tha edhe kryetari se mungon vullneti për ta zgjidhur problemin e kamotshëm për Teatrin e Gjilanit. Ky vullnet po të ekzistojë mund të zgjidhet sot, sepse në fund duhet të dalim me rekomandime dhe nëse nuk kemi rekomandime dëshmohet ajo që nuk ka vullnet për ta gjet zgjidhjen.

Mirëpo rrugën të cilën e propozoi kryetari për ta zgjidhur kërkon kohë, prandaj krejt çka kërkohet në fund është se duhet të bëhet një zgjidhje konkrete ligjore, me një mbështetje financiare për 6 muajt e këtij viti dhe gjatë rishikimit të buxhetit të gjendet mundësia për ta ndarë edhe një buxhet tjetër të

aprovuar këtë vit për 2015, kurse vitin tjetër në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës ta kemi një zgjidhje të pranueshme për teatrin. Unë jam i bindur se po të ekzistojë vullneti jam i bindur se do të gjendet zgjidhja.

Valentina Bunjaku- Rexhepi- kryetari i Komunës do të vazhdojë për t' i subvencionuar aktorët si deri më tani, mirëpo aktorët duhet të kenë durim dhe të presin deri në zgjidhje afat gjate, duke u koordinuar ministri, drejtori dhe teatër. Nuk ka nevojë të debatojmë më tepër, sepse nuk kemi mundësi për ta shkelur ligjin.

Zijadin Maliqi- unë propozoj që ta nxjerrim si rekomandim që kryetari së bashku me Këshillin Drejtues të Teatrit dhe me Njësinë për Kulturë, Rini dhe Sport, por edhe me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa ta gjejnë një zgjidhje të përkohshme dhe ta formojnë një nën kod ku do të lëshohen mjetet, sepse e tha edhe kryetari se paga nuk ka mundësi të jepen, por Komuna mundet t' i financojë projektet ta jep një fond, pastaj teatri menaxhon me atë fond. Mirëpo për të ardhmen të punohet në drejtim të kthimit të statusit të teatrit si e ka pasur edhe më parë.

Valentina Bunjaku- Rexhepi- vullneti i të gjithëve ekziston për ta ndihmuar Teatrin e Qytetit, prandaj unë mendoj se kryetari i Komunës duhet të del me një rekomandim me Njësinë për Kulturë për ta bërë një zgjidhje të përhershme në koordinim me Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport Ju lus të deklarojeni se kush është për këtë rekomandim.

Aprovohet rekomandimi të cilin e propozoi kryesuesja me 26 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerat ishin abstenime.

2.2. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve të Shoqatave dhe Klubeve Sportive të Komunës së Gjilanit

Lutfi Haziri- në funksion të kësaj dhe njëri prej qëllimeve që unë i kam rekomanduar KPF-së dhe KK-së që pjesën e subvencioneve ta rregullojë në marrëdhënie kontraktuale në mes të palëve, ka kuptimin që subvencionet e paraqitura sipas programeve, që programet të zbatohen nën një dhe nën dy të mbyllen dhe nën tre të auditohen. Në çdo marrëveshje që e nënshkruajmë me klube shoqata, klube sportive dhe rrjete rinore nuk e nënkupton me automatizëm bartjen e mjeteve, por nënkupton se brenda tyre mjeteve mund të paraqiten programe të caktuara dhe mund të shfrytëzohen brenda një viti. Disa kërkesa me shumica të mëdha është e pamundur për t' i financuar, por ne e marrim për obligim për t' i kategorizuar. P.sh Hendikosi si OJQ e cila merret me njerëz me kategori të veçantë është OJQ e cila duhet të mbështetet dhe garantohet nga buxheti, apo subvencionimi i buxhetit komunal në mënyrë që të jenë funksional, sepse tash nuk kanë donatorë serioz.

Ju e dini që kryetari i Komunës ka të drejtë të ndaj subvencione deri në një masë të caktuar, por nuk jam i interesuar për t'ia ndarë akujt as 100 € pa mbulesë, mirëpo kërkesa ka prej 100 deri në 100 mijë €. Një festival "Gjilani 2015" nuk është propozimi joni ose botimet letrare të Beqir Musliut është ide e mirë, por është kosto shumë e madhe. Çdo vendim i cili duhet të merret duhet pasur parasysh edhe mundësinë buxhetore dhe kjo është arsyeje që gjithmonë kërkesa duhet të kalojë në ekzekutiv në mënyrë që Zyra për Buxhet t' i tregojë mundësitë financiare që janë.

Mirëpo marrëveshjet të cilat i kemi nënshkruar ne e dimë mundësinë buxhetore dhe ato garantojmë se do t' i financojmë. Kërkesat që vijnë pa mbulesë financiare janë kërkesa vështirë të realizueshme. Mirëpo Kuvendi duhet ta ketë fjalën e vetë dhe nëse ju vlerësoni se duhet një kërkesë të hedhet poshtë dhe unë e respektoj autoritetin e juaj. Unë iu lus që propozimet që kanë certifikatë të buxhetit që kanë mbulesë buxhetore t' i merrni parasysh, kurse rekomandimet për festivale dhe aktivitete të tjera që janë të rëndësishme për Gjilanin t' i matni me parametra buxhetor.

Zijadin Maliqi- kryetari e dha një sqarim, por edhe e kemi listën e klubeve dhe shoqatave të cilat duhet t' i lëshohen mjete, por kjo nuk nënkupton se këto mjete duhet të lëshohen menjëherë, por ato do të lëshohen në bazë të projekteve të cilat do t' i paraqesin. Përgjegjës për t' i lëshuar këto mjete

është drejtoria përkatëse, por kjo drejtori nuk duhet t' i lëshojë mjetet për pa u bërë arsyetimi i subvencioneve të marra më parë. Auditimi duhet të bëhet patjetër, prandaj unë në emër të grupit të LDK jam që ta aprovojme këtë listë për dhënie të mjeteve në këtë mënyrë.

Jehonë Hyseni- sa i përket financimit të klubeve dhe shoqatave të ndryshme, unë kam një kërkesë dhe kjo kërkesë ka të bëjë me Klubin Hendbollit të Zhegrës, sepse ky Klub ka arritur shumë suksese në Komunë të Gjilanit. Ky klub është në super ligë me katër ekipe, senior, junior, kadet dhe pionier me gjithsejtë 40 lojtar aktiv. Ky është Klub i vetëm gjilanas i cili ka marrë pjesë në super ligë të Kosovës. Juniorët janë kampion këtë vit, por edhe vitin e kaluar. Në përgjithësi ky klub ka arritur rezultate shumë të mira edhe pse punon dhe vepron në kushte mjaft të vështira, sepse nuk ka sallë për stërvitje dhe i duhet lojtarëve të udhëtojnë prej Zhegrës në Gjilan nga katër herë në javë e të cilat shpenzime nuk ia kompenson askush. Për shkak të këtyre kushteve, por në anën tjetër për shkak të sukseseve solide që i ka arrit ky Klub i Hendbollit, propozoj që këtij klubi t' i ndahet një shumë prej 1 mijë €, sepse nëse bëhet krahasimi me disa klube të tjera, klubit të Zhegrës meriton që t' i ndahen 10 mijë €.

Lufti Haziri- për ta sqaruar për ata që e kanë bërë renditjen për sport dhe për OJQ duhet ditur se ne nuk e kemi përfshirë këtu shumën e mjeteve që janë mbi 4 mijë €. Kjo është bërë, sepse për ato mjete ka të drejtë ekzekutivi të vendos dhe në këtë kategori mbi 4 mijë € hynë edhe Klubi i Hendbollit “Zhegra”. Nëse ka nevojë dhe arrihen rezultate të veçanta ne i dyfishojmë subvencionet e klubeve dhe atë si pjesë e grantit apo e dhuratës që i epet klubeve për ta stimuluar rezultatin.

Shtëpia për Mbrojtjen e Nënës dhe Fëmijëve “Liria”, por e presim nga Ambasada Norvegjeze e cila sipas projektit ta caktojë shumën se sa mjete ata do t' i ndajnë për këtë shtëpi në mënyrë që ne ta plotësojmë nevojën e subvencionimit. Nëse nuk ka reagim nga ambasada ne do të veprojmë në të njëjtën mënyrë si kemi reaguar më parë.

Fehmi Sylejmani – sa i përket subvencioneve të klubeve sportive edhe ne si grup LVV, parimisht i përkrahim, por kërkojmë të jemi më rigoroz gjatë auditimit. Këtë po e theksoj, sepse disa klube posaçërisht nga klubet e futbollit ka pasur keqpërdorime të mëdha.

Për hir të së vërtetës unë po iu njoftoj me të dhëna zyrtare të cilat i kam marrë nga klubet si në vijim:

Klubi i Futbollit “Drita” është ndihmuar me 30 mijë €, Klubi i Futbollit “Gjilani” është ndihmuar me 7 mijë €, por për të dy klube janë zotuar për “Dritën” edhe 4 mijë €, kurse për Gjilanin e dhe 3 mijë €. Klubi i Basketbollit “Drita” është ndihmuar me 7800 €, kurse tash pritet të ndihmohen edhe me 10 mijë €, por unë po e bëj një korrigjim, sepse Klubi i Basketbollit “Drita” nuk bënë gara as në ligën e parë, sepse është shuar për shkak të mungesës së mjeteve dhe Klubi i Basketbollit për meshkuj nuk merr pjesë në asnjë ligë. Në listën e cila figuron për klubet sportive po vërehet se janë ndihmuar në përgjithësi të gjitha klubet, por edhe ne kërkojmë që të gjitha këto klube të ndihmohen në mënyrë që mos të krijohet pakënaqësi në mes të klubeve. Mirëpo një duhet ta dimë se një klub i cili është në super ligë duhet t' i ndihmohet më shumë, por është e logjikshme që të kenë përparësi edhe sportet më të popullarizuara dhe nëse është sport ekipor.

Mirëpo nuk duhet harruar edhe kubet e karatesë, sepse në këtë sport kemi rezultate kulmore, kemi edhe kampion botëror dhe duhet të jemi të kujdesshëm që t' i ndihmojmë. Mirëpo unë në fund kërkoj që gjithmonë të jetë një auditim shumë serioz për këto mjete të cilat do të ndahen për këto klube, sepse ka pasur mjaft keqpërdorime.

Selami Xhemajli- edhe ne si AAK e përkrahim në parim subvencionim e aktiviteteve të klubeve sportive, mirëpo kërkesat për subvencionim para se të kalojnë në Komitetin për Kulturë, Rini dhe Sport po vijnë të pagdhendura, sepse shumat janë të paarsyeshme. P.sh 2 mijë € të kërkohen për veprat e Beqir Musliut vetëm për koordinim është një shumë e madhe. Për këtë arsyeje të gjitha projektet duhet të shikohen, analizohen në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet në mënyrë që të

dihet se sa ka mundësi të ndihmohen këto projekte të klubeve. Pas këtyre analizave, rekomandimi i KPF të jetë meritohet dhe i arsyeshëm, kurse në Kuvend vetëm të aprovohet. Nuk duhet të propozohen shuma marramendëse për të cilat Kuvendi nuk mund të marrë vendim. Jam për atë që të bëhet ky subvencionim me propozim të z. Sylejmani që të bëhet gjithmonë auditim për mënyrën e shpenzimit të mjeteve.

Fatbardhë Selmani- unë fillimisht po e paraqes një shqetësim në emër të grupit kuvendar të PDK-së, sepse në vazhdimësi nuk po respektohet e drejta e fjalës, sepse që nga fillimi i diskutimit të kësaj teme unë e kërkoj fjalën e që sipas rregullore fjala i epet së pari grupit më të madh kuvendar, por kjo nuk ndodhi në këtë rast.

Në këtë propozim vendim e konsiderojmë të padrejtë diskriminues dhe mjaft të dëmshëm. Z. Lutfi Haziri, gjatë fushatës zgjedhore kishte premtuar mbështetje financiare për të gjitha klubet sportive të Gjilanit, por kjo tash nuk po ndodh. Dy klubet e futbollit e meritojnë këtë mbështetje financiare dhe pse nuk është e mjaftueshme, sikur për klubet e basketbollit dhe volejbollit. Mirëpo shtrohet pyetje se ku po mbesin edhe klubet e tjera sportive, sepse atyre nuk u ofrohet edhe asnjë lloj mbështetje financiare, bile as transporti kur mbahen gara të ndryshme. Është shuar dhe Klubi i Basketbollit “Drita”, sepse nuk kanë pasur mundësi ta bëjnë pagesën e kuotizimiti e cila vlerë ishte 2. mijë €.

Ky klub ka qenë një ndër më të suksesshmit, por tash ky klub është shuar dhe duhet t’i fillojë garat që nga liga e parë dhe kjo mbështetje financiare konsiderojmë se është e vonuar dhe ne si opozitë e mbështesim financimin e të gjitha klubeve sportive nga buxheti komunal, por nuk do të lejojmë që të ndodh ky diskriminim i plotë i sportit gjilanas. Nuk është e drejtë që dy shoqatave t’i ndahen nga 5 mijë €, kurse në anën tjetër të mos i ndahen as 1 mijë €. Shoqatës së Gruas “Liria” e cila kryen aktivitete jashtëzakonisht të rëndësishme. Ne jemi që të mbështeten këto klube, por jemi për atë që të përfshihen edhe klubet e tjera dhe organizatat e tjera rinore të cilat janë të rëndësishme për Komunën e Gjilanit. Shumë klube nuk kanë përfutur asnjë cent, kurse në anën tjetër iu kanë ndarë nga 5 mijë € kompanive të ndryshme private të cilat merren me manifestime dhe organizime të tyre private dhe biznese. Ju kërkojmë që ju si qeverisje që të jeni më zemër gjerë edhe për shumë klube dhe shoqata të tjera dhe ta mbani premtimin të cilin e keni dhënë gjatë fushatës zgjedhore.

Arben Maliqi- unë e falënderoj kryetarin e Komunes i cili edhe kur nuk ka qenë kryetar, ka kontribuar për rininë dhe gjithmonë ka qenë me sportin dhe e ka dashur me zemër.

Sa i përket Qendrës Rinore dhe Këshillit të Veprimit Rinor, unë mendoj se kjo shumë e cila është ndarë mendoj se është plotësisht e merituar, sepse rinia merret me aktivitete të veta në mënyrë që mos të qëndrojnë në lokale të cilat janë të papërshtatshme për rininë. U tha se ndarja e subvencioneve duhet të bëhet për sportet e ndryshme, por nuk janë të gjitha sportet e barabarta, prandaj disa sporte kërkojnë një angazhim më të madh si është Klubi i Futbollit “Drita” të cilit klub duhet t’i ndahen më shumë mjete.

Mirëpo me shumë rëndësi është edhe Shoqata e Pedagogëve të Kulturës Fizike e cila funksionon në Komunë të Gjilanit dhe e cila ka arritur suksese solide. Afër 1 mijë e 700 nxënës kanë marrë pjesë në gara regjionale të cilën shoqatë e përgëzojmë për këtë sukses të dalluar.

Një ndër sportet e dalluar në Komunë të Gjilanit është sporti i karatesë dhe këtë sport duhet ta përkrahim dhe ta financojmë ashtu si duhet për të arritur suksese edhe më të mëdha.

Krahas sportistëve duhet t’i përkrahim edhe punëtorët të cilët i mirëmbajnë fushat e sportit, sepse këta punëtorë në aspektin financiar nuk janë në gjendje të mirë.

Lutfi Haziri- ju falënderoj për sugjerime, por unë do të shikoj nëse ka mbetur ndonjë klub pa përkrahje, por sipas mendimit tim nuk ka mbetur asnjë klub, por dhe asnjë individ i cili ka kërkuar mbështetje për gara ndërkombëtare nuk ka mbetur për pa u përkrahur. Mirëpo si rast i veçantë është Klubi i Basketbollit “Drita” dhe për hir të opinionit po iu informoj se ky klub është larguar nga gara me vendim të Federatës së Kosovës për shkak të obligimeve që i ka pasur në vlerë prej 12 mijë e 500 €, por edhe 4 mijë e 500 € për bileta. Ky është problemi i Klubit të Basketbollit “Drita” i cili

problem nuk ka të bëjë me Gjilan. Ne nuk mund të marrim obligime të mëparshme e të cilat janë mbi 16 mijë €. Ne po punojmë për ta rikthyer këtë klub në gara, duke marrë obligime ne pranë Federatës së Basketbollit të Kosovës. Komuna duhet të marrë për obligim për t' i servisuar obligimet në mënyrë që klubi të kthehet në gara.

Sa i përket Shoqatës së Gruas "Liria", ne po presim një donacion nga Qeveria Norvegjeze, por nëse nuk realizohet ky donacion, atëherë ne si Komunë duhet t' i marrim obligimet për ta financuar këtë shoqatë në tërësi, sepse kjo shoqatë ka stehimore e cila garanton mbrojtjen e grave dhe fëmijëve nga dhuna në familje.

Riad Rashiti- unë e kam një pyetje dhe një vërejtje. Pyetja është, se pse ky vendim nuk ka kaluar nëpër trupën e KK gjegjësisht Komitetit për Rini, Kulturë dhe Sport ? Unë mendoj se këto propozim vendime ka qenë desh të vijnë nga komiteti përkatës.

Si çështje e dytë është mirë që përgjegjësi për Kulturë, z. Bujar Haziri të na informojë për kërkesat të cilat i shkojnë dhe sa është planifikuar të ndihmohen? Duhet të na sillen informatat për Qendrën Rinore se kush është menaxher i kësaj qendre, çfarë aktivitet kryen?

Ne mendojmë se ka anashkalime të procedurave dhe ka mungesë të informacioneve për aktivitete të ndryshme të OJQ-ve dhe klubeve sportive.

Lutfi Haziri- spnzorues i këtyre marrëveshjeve dhe nënshkrues i këtyre marrëveshjeve dhe paraqitësi i kërkesave në KPF, jam unë. Unë nuk i kam negociuar çmimet, por kam biseduar me përfaqësuesit e shoqatave dhe klubeve do të thotë i kemi biseduar programet vjetore që i kanë e të cilat i kemi ndihmuar sipas mundësive buxhetore të cilat i kemi pasur.

Secila palë fillimisht ka nënshkruar marrëveshje, pastaj e kam nënshkruar unë dhe i kanë pranuar kushtet dhe e kanë pranuar shumën.

Jashar Jashari- z. jashari gjatë fjalës së tij e dha në sqarim të shkurtër për historikun dhe veprimtarinë e Shoqatës së Gruas "Liria" e cila fjalë u dorëzua me shkrim në sekretarinë e Kuvendit e cila fjalë do t' i bashkëngjitet procesverbalit.

Përkitazi me këtë pikë përfundoi debati, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pik 2.2 e rendit të punës.

Aprovohet pika 2.2. e rendit të punës: Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve të shoqatave dhe klubeve sportive të Komunës së Gjilanit, me 29 vota të anëtarëve të kuvendit, kurse të tjerat ishin abstenime.

2.3. Kompensimi i Komisionit për plotësimin e emërimit të rrugëve dhe numërimit të adresave për territorin e Komunës së Gjilanit

Valentinë Bunjaku –Rexhepi- të gjithë jeni të njoftuar se KK e ka formuar një Komision për emërtimin e rrugëve dhe shesheve i cili komision është formuar në bazë të kriterëve partiake ose në bazë të ulësive në KK. Mirëpo ky komision duhet kompensuar.

Propozimi i im është që ky komision të paguhet sikurse komitetet obligative derisa ta përfundojnë punën e tyre. Sipas kësaj do të thotë që takimi të paguhet 50 €, ashtu si komitetet obligative.

Nevzad Rushiti- unë e kam një informatë, se në këtë Komision nuk marrin pjesë të gjithë anëtarët të cilët janë propozuar. Ky komision e ka një punë me shumë rëndësi të cilin duhet ta kryer, por nuk e ka mandatin 4 vjeçar si anëtarët e Kuvendit. Sa i përket pagës edhe unë pajtohem me propozimin e kryesuese, sepse më tepër nuk ka mundësi të paguhet ky komision.

Serdjan Mitroviç- në Gjilan kemi edhe pjesëtarë të komunitetit serb, prandaj propozoj që në këtë Komision të bëhet një plotësim dhe të zgjidhet edhe një anëtarë nga komuniteti serb për emërtim të rrugëve dhe shesheve. Ne kemi rrugë, kemi institucione dhe sheshe publike e të cilat duhet të

emërtohen, prandaj nuk është në rregull nëse në këtë komision nuk është edhe një anëtar i komunitetit serb. Këtë propozim të cilin po e bëjë e garanton edhe ligji, sepse komunitetet duhet të jenë të përfaqësuar në të gjitha komitetet dhe institucionet e tjera.

Në bazë të kësaj që po vërehet secili koleg i imi është së paku anëtar i dy komiteteve, kurse deri më sot unë nuk jam anëtar i asnjë komiteti. Unë mendoj se sipas ligjit minimum nga komuniteti serb duhet të jetë një anëtar në Komitetin për Buxhet dhe Financa, por kjo mund të bëhet edhe në mënyrë rotative me një anëtarë të komunitetit turk. Unë kërkoj që të bëhet ky përmirësim, sepse gjatë kohës kur janë bërë propozimet për anëtarë të komiteteve, për kthimi dhe aparatúra për përkthim nuk kanë qenë në nivel dhe nuk kam pasur mundësi t' i përcjell punimet e seancës.

Valentinë Bunjaku Rexhepi- në Komitetin për Komuniteti janë dy serb si anëtar të këtij komiteti, por edhe Këshilli i fshatrave e ka një përfaqësues. Ndërsa sa i përket komisionit për emërtim të rrugëve do ta shqyrtoj këtë kërkesë dhe do të përgjigjem me shkrim.

Sedjan Mitroviç- më intereson se kush e ka bërë propozimin për anëtarë të Komitetit për Komunitete?

Sadri Arfi- propozimi i anëtarëve të Komitetit për Komunitete bëhet në bazë të një rregulloreje të MPL-së e cila i përcakton kriteret se si zgjidhen anëtarët e Komitetit për Komunitete? Së pari bëhet debat publik me qytetarë dhe me atë komitet, pastaj plotësohet një aplikacion të cilin e paraqesin tek kryesuesja e Kuvendit, pastaj kryesuesja e emëron anëtarët nga preferenca e tubimit me qytetarë. Sa i përket tubimit publik është mbajtur sipas ligjit dhe nga kjo sallë janë zgjedhur anëtarët e Komitetit për Komunitete dhe për përfaqësuesit serb dhe atij turk.

Serdjan Mitroviç- unë me përgjegjësi po e them se këto tubime nuk janë mbajtur, kurse procedurën e di dhe e kam të qartë se si duhet të veprohet?

Valentinë Bunjaku Rexhepi- ne kemi mbajtur tubime me komunitete dhe janë dy serb të përfaqësuar në Komitetin për Komunitete, kurse një është në Këshillat e fshatrave e të cilin propozim e ka bërë vetë z. Mitroviç. Sa i përket KPF-së, kërkesa e z. Mitroviç është shumë e vonuar, por në këtë kërkesë do ta shqyrtojmë dhe do të përgjigjemi me shkrim.

Lidhur me këtë pikë në debat morën pjesë: Renan Imam, Nevzad Isufi, Ismet Hajdini, Halit Rexhepi, Sahit Abazi, Arben Maliqi, Riad Rashiti.

Pas këtyre debateve, të gjithë anëtarët e KK u pajtuan që Komisioni i për emërtim të rrugëve dhe shesheve të paguhet nga 50 € ashtu si anëtarët e tjerë të komiteteve.

Aprovohet kërkesa që anëtarët e Komisionit për emërtim të rrugëve dhe shesheve të paguhet 50 € për një muaj duke filluar nga data e fillimit të punës së Komisionit, me 19 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerat ishin abstenime.

2.4-Propozim vendimi për funksionalizimin e Komitetit për bashkëpunim ndërkufitar dhe Komitetit për Barazi Gjinore

Valentinë Bunjaku Rexhepi- për këtë çështje, unë paraprakisht kam kërkuar që propozimet të dorëzohen me shkrim, por për të dhënë sqarime fjalën e po e barti te shefi i grupit të LDK-së.

Avdyl Aliu- nga LDK në Komitetin për bashkëpunim Ndërkufitar është propozuar Miranda Bllaca, Artan Cani dhe nga zemërgjerësia e kemi lënë një vend për PD-në Alisahit Halili.

Për Komitetin për Barazi Gjinore janë propozuar: Arijetë Aliu, Nexhat Hajrullahu dhe Jonuz Hasani.

Sahit Abazi – PDK për Komitetin për Bashkëpunim Ndërkufitar e propozon Riad Rashitin, kurse në Komitetin për Barazi Gjinore zonjën Xhezide Ismaili.

Selami Xhemajli- AKK në Komitetin për Bashkëpunim Ndërkufitar e propozon, z. Sami Azemi kurse në Komitetin për Barazi Gjinore Sabri Rexhepin.

Nevzad Isufi- nga LVV për Komitetin për Bashkëpunim Ndërkufitar e propozon Muhamet Rexhepin, kurse në Komitetin për Barazi Gjinore Kadrie Hajdarin.

Valentinë Bunjaku Rexhepi- të tjerët janë për Bashkëpunim Ndërkufitar Sadullah Kadriu, kur në Komitetin për Barazi Gjinore Renan Imam.

Sadullah Kadriu – unë jam i mendimit se në Komitetin për Bashkëpunim Ndërkufitar neve na takojnë dy vende, por pasi nuk është vepruar kështu unë kërkoj që të tërhiqem dhe në vend timin e propozoj një kandidatë tjetër Mirëpo do të ishte e udhës që LDK ta reduktoj numrin prej tre anëtarëve dhe të jenë dy anëtarë, kurse ne t' i kemi dy anëtarë për shumë arsyeje të cilat janë të njohura.

Unë në vend timin e propozoj Ismet Tafilin.

Serdjan Mitroviç – në pajtim me atë që e thash më parë, unë propozoj që të kemi një anëtar në Komitetin për Barazi Gjinore.

Arben Maliqi- unë e kam një vërejtje të madhe për të gjithë dhe kjo vlen edhe për LDK-në, PDK-në dhe AAK-në dhe të gjithë të tjerët, sepse më mirë dhe më e drejtë është që të jenë dy femra dhe një mashkull në Komitetin për Barazi Gjinore.

Avdyl Aliu-Komiteti për Barazi Gjinore i ka 7 anëtarë dhe prej tyre tri janë femra.

Shukrie Rapuca- sa i përket Komitetit për Barazi Gjinore, është krejtësisht qesharake nëse dominojnë meshkujt në atë komitet, sepse femrat përsëri mbesin minoritet. Ne jemi marrë vesh ndryshe, por gjërat po marrin kahe tjetër në seancë.

Po e shfrytëzoj rastin edhe për rastin e Komitetit për Bashkëpunim Ndërkufitar, sepse u propozua që në këtë komitet të jetë edhe një anëtar nga Kosova Lindore e të cilin propozim e përkrahi plotësisht.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja propozon që të aprovohen propozimet për këto dy komitete?

Aprovohet lista e propozuar e anëtarëve të Komitetit për Bashkëpunim Ndërkufitar dhe atij për Barazi Gjinore me 27 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenuan.

2.5 Ndarja e mjeteve financiare për botimin e dorëshkrimeve letrare-publicistike të Beqir Musliut

Valentinë Bunjaku Rexhepi- pika e rendit të punës 2.5 dhe 2.6- Ndarja e mjeteve financiare për projektin e Festivalit “Gjilani 2015”, propozoj që të kthehen në rishqyrtim, sepse kjo është një shumë e madhe, kurse mundësitë financiare janë vogla edhe pse ne në parim vullnetin dhe dëshirën e kemi për t' i ndihmuar kulturës.

Izmi Zeka- mua më duket se janë ngatërruar këto dy kërkesa, por sa i përket botimit të dorëshkrimeve të Beqir Musliut, unë i kisha kërkuar të gjitha mundësitë e mundshme ligjore dhe

këtë propozim do ta kisha realizuar, sepse ato dorëshkrime janë një thesar i çmuar për Komunën e Gjilanit. Po të isha në vend të kryesues një vendim me siguri do ta kisha marrë dhe në konsultim me ata të cilët e kanë bërë kërkesën dhe do ta kishim shqyrtuar se ku mund të kursejmë për ta realizuar këtë projekt. Pika 2.6 është aspekt tjetër, sepse Komuna e Gjilanit ka institucione të cilat mund ta realizojnë një festival të tillë. Unë në emër timin propozoj që një vendim ta marrim dhe nuk e kisha shtyrë këtë çështje, sepse veprat e Beqir Musliut i tejkalojnë përmasat komunale dhe arrijnë deri në nivel kombëtar.

Mevlyde Zejnullahu- unë përkrahi mendimin e z. Zeka dhe po theksoj se e njëjta histori po përsëritet edhe pas 20 viteve. Unë i përkas asaj familje, sepse familja e bashkëshortit tim është shumë të afërt me Beqir Musliun, por edhe më 1995 është biseduar përkitazi me shkrimet e Beqir Musliut. Edhe atë kohë disa dorëshkrime të këtij autori nuk janë botuar për shkak të mjeteve financiare. Unë propozoj që kjo të analizohet mirë dhe ky propozim të miratohet.

Isa Agushi- edhe unë pajtohem me z. Izmiun dhe kjo në çdo mënyrë duhet të kalojë. Nëse është shumë e madhe, të bëhet një reduktim i mjeteve, por kjo duhet kalojë.

Nevzad Isufi- në këtë rasat kemi të bëjmë me një emër i cili është krenaria e Gjilanit, sepse Beqir Musliu nuk është shkrimtar me përmasa komunale, por arrin në nivel kombëtar me veprat e tij letrare. Edhe unë jam që të epet mundësi dhe kjo të kalojë, por të shikohet mundësia që këto botime mos të na vijnë me çmime standarde, sepse ka mundësi të negociohen edhe çmimet e botimeve dhe mos ta shtyjmë deri në pakufi.

Ismet Hajdini- të mos krijohen keqkuptime dhe unë jam i bindur se komplet Asambleja Komunale është për miratimin e këtij propozimi. Mirëpo janë në pyetje mundësitë buxhetore të Drejtorisë së Kulturës, por edhe është një moskuptim, sepse thuhet 2 mijë € për koordinim të punës. Unë nuk e kuptoj se për çka janë këto mjete për koordinim të punës. Duhet arsyetuar çdo mjet, sepse të gjithë jemi për ta aprovuar këtë pikë.

Shpresë Kurteshi – Komiteti për Kulturë, Rini dhe Sport e ka shqyrtuar këtë çështje, por vlera që kërkohet nuk është edhe shumë e madhe nëse e krahasojmë kontributin e Beqir Musliut. Mirëpo në aspektin buxhetor për Komunën është mjaft i madh. Ne e kemi përcjell këtë propozim me rekomandimin që KPF ta shqyrtojë dhe të jetë në bashkëpunim me Drejtorinë për Financa dhe ta jap një shifër për të parë se sa ka mundësi të ndahen mjete për këtë botim?

Në parim jemi për, por edhe njëherë duhet ky propozim të shqyrtohet në Drejtorinë për Financa dhe kjo drejtori të deklarohet se sa mjete ka mundësi t'i ndajë për këtë botim?

Valentinë Bunjaku Rexhepi- nuk duhet të keqkuptohemi, sepse të gjithë duhet ta përkrahim këtë Klub, por realisht e kemi bërë një lëshim, sepse nga vullneti i mirë për ta ndihmuar nuk i kemi analizuar mirë shifrat. Pas KPF-së, jemi konsultuar me Drejtorinë për Buxhet, por atëherë e kemi kuptuar se nuk ka mjete, prandaj unë kërkoj nga ky Kuvend që ky propozim të rikthehet në rishqyrtim dhe të specifikohen mirë shifrat. Tash bëhet rishikimi i buxhetit dhe do të shqyrtohet mundësia e ndihmës së këtij projekti.

Ju lutem të deklaroheni se kush është që pika 2.5 dhe 2.6 të kthehet në rishqyrtim?

Kuvendi me 23 vota, aprovoi propozimin që pika 2.5- Ndarja e mjeteve financiare për botimin e dorëshkrimeve letrare-publicistike të Beqir Musliut dhe 2.6- Ndarja e mjeteve financiare për projektin e Festivalit “Gjilani 2015” të kthen në rishqyrtim

2.7- Rekomandim për Qeverinë e Kosovës (MPB) për nxjerrjen e UA për krijimin e lehtësirave për qytetarët e Kosovës Lindore

Valentinë Bunjaku Rexhepi- kjo pikë e rendit të punës është sponzoruar me kërkesë të z. Sadullah Kadriu, por kjo çështje nuk varet nga KK, por ne mund ta bëjmë vetëm një rekomandim në Qeveri për t' i mundësuar disa lehtësira në nxjerrje të dokumentacionit qytetarëve të shpërngulur nga Kosova Lindore.

Sadullah Kadriu- z. Kadriu në seancë dha sqarime përkitazi me shqetësimet dhe vështirësitë me të cilat po ballafaqohen qytetarët e Kosovës Lindore të shpërngulur në Gjilan.

Fjalën e thënë në Kuvend, z. Kadriu e dorëzoi me shkrim në sekretari e cila ekspozë do t' i bashkëngjitet procesverbalit.

Fehmi Sylejmani- unë e përkrahi atë që e tha z. Kadriu, sepse është shumë reale, është shumë e vërtetë se gjendja e atyre qytetarëve është shumë e rëndë. Këta qytetarë janë në gjendje të mjerueshme, sepse iu duhet të barten nëpër godina dhe sportele, kurse në fund kthehen për pa kryer punë. Ato që i tha z. Kadriu, janë disa gjëra shumë burokratike, prandaj për t' i lehtësuar punën këtyre qytetarëve duhet shkurtuar disa procedura në mënyrë që sa më lehtë dhe më shpejtë ta marrin dokumentacionin. Edhe pse këta qytetarë janë në një periudhë prej 15 vite banorë të Gjilanit ende nuk mund ta marrin një dokument për ndihmë sociale.

Për t' i lehtësuar punën këtyre qytetarëve Komuna nuk është kompetente, por ne mund ta bëjmë një rekomandim në nivelin Qendror për t' i bërë lehtësime në nxjerrje të dokumentacionit këtyre qytetarëve.

Isa Agushi- unë plotësisht e përkrahi z. Kadriu dhe pajtohem me atë që tha në këtë seancë. Unë jam në dijeni me problemet të cilat i kanë qytetarët e Kosovës Lindore në Gjilan, prandaj ne mund ta bëjmë një rekomandim në Qeverinë e Kosovës, por edhe problemi tjetër është se këtyre qytetarëve i shkelen të drejtat elementare sikurse shqiptarëve në Maqedoni. Edhe në Maqedoni është a pamundur për ta marrë një nënshtetësi edhe pse ka lindur personi në Maqedoni.

Ne si Kuvend duhet ta bëjmë një rekomandim të ashpër Qeverisë së Kosovës në mënyrë që t' iu del në ndihmë këtyre njerëzve.

Sahit Abazi- në emër të grupit edhe ne mbështesim kërkesën që t' i rekomandohet MPB-së që t' i bëjë lehtësime maksimale këtij komuniteti të njerëzve të cilët edhe pas 15 viteve jetojnë në Gjilan pa dokumentacion. Mirëpo qytetarë të Kosovës Lindore ka edhe në qytete tjera e të cilat probleme i kanë edhe në ato komuna ku jetojnë. Mirëpo problemi është edhe më i thellë, sepse ka ndodhur një shpërngulje masovike prej Luginës, kryesisht në Anamoravë, por po vazhdon të jetë edhe një shpërngulje sporadike edhe sot. Ne duhet ta bëjmë një rekomandim, por duhet bërë edhe një tjetër rekomandim dhe Qeveria e Kosovës t' i shfrytëzoj negociatat që po i bën me Serbinë që të fillojë ofensiva për kthimin e qytetarëve të kësaj treve në pronat e veta. Për mua më me interes është që këta qytetarë të kthehen në Luginë se sa t' i japim dokumentacion. Të bëhet një dialog për kthim të këtyre shqiptarëve në trojet e veta ashtu si po bisedohet për kthim të serbëve dhe komuniteteve tjera në shtëpitë e tyre në Kosovë.

Nevzad Isufi- edhe unë po pajtohem me parafolësit, por sipas Kushtetutës së Kosovës çdo qytetarë i cili pesë vjet ka jetuar në Kosovë e fiton shtetësinë. Te ne edhe kinezët nga Kina e lartë e kanë fituar shtetësinë e Kosovës, kurse ne ende nuk i krijojmë lehtësira njerëzve tanë të cilët janë shpërngulur në mënyrë të dhunshme. Unë pajtohem me kolegun Abazi, por kthimi duhet të bëhet me vullnetin e tyre dhe ne nuk duhet t' i mbajmë peng dhe mos t' i pajisim me dokumentacion, sepse këta ka qenë desh tri herë ta fitojnë shtetësinë deri më tash.

Isa Agushi- unë nuk jam për t' i dhënë shtetësi atyre që vijnë sot në Gjilan, por jam për t' i dhënë shtetësi atyre që jetojnë qe 10-15 vite në Gjilan ose qytete tjera të Kosovës. Këta qytetarë i kanë

pronat e veta, shtëpitë, këtu jetojnë, fëmijët shkojnë në shkollë, prandaj këtyre duhet dhënë nënshtetësi dhe jo për ata që vijnë rishtaz.

Sahit Abazi- ne pajtohem që ta bëjmë një rekomandim Qeverisë së Kosovës për qytetarët të cilët jetojnë qe 15 vjet në Gjilan, por ne gjithashtu duhet ta bëjmë edhe rekomandimin e dytë si plotësim për njerëzit të cilët dëshirojnë të kthehen në Preshevë dhe Bujanoc, sepse kemi vështirësi për kthim të tyre.

Selami Xhemajli- edhe ne e përkrahim rekomandimin i cili duhet t' i bëhet Qeverisë së Kosovës, por në atë fjalën të cilën e lexoi z. Kadriu ka disa kërkesa të cilat janë të pamundshme, sepse nuk kanë qasje në institucionet ku duhet nxjerr dokumente. E kam fjalën për njerëz të cilët kanë kontribuar për këtë vend e të cilët kanë qenë pjesë e luftës së UÇK-së, kurse sot nuk kanë qasje në shtetin e Serbisë për ta nxjerr një dokument që i kërkohet për ta fituar shtetësinë edhe pse i plotëson të gjitha kushtet. Këta njerëz janë banorë të Gjilanit, fëmijët i kanë në shkollë, kurse ne ata njerëz po i diskriminojmë dyfish. Mirëpo pjesë e rekomandimit të duhet të jetë që këta njerëz të mos ndiqen penalisht për diçka të kaluar dhe jo për vepra kriminale të zakonshme. Nga Qeveria e jonë si primare është që këtyre njerëzve t' i krijojmë lehtësira për pajisje me dokumente.

Sadullah Kadriu – kjo është një temë e gjerë, por unë nuk e njoh asnjë njeri i cili dëshiron të vijë nga Bujanoci vetëm sa për t' i marrë dokumentet. Z. Abazi pati të drejtë dhe unë kam marrë iniciativë që të asfaltohet rruga në Malësi të Bujancit në gjatësi prej 5-6 km. Këtë ne do ta realizojmë me vetë kontribut dhe pjesëmarrje të Komunës. Unë jam i bindur se me asfaltim të kësaj rruge shumë qytetarë do të kthehen, por problemi është se një zonjë 16 vjet jeton në Bresalc dhe punon në KEK, por pas 16 viteve asaj iu është thënë duhet të largohet nga puna, sepse nuk mund t' ia bëjnë pagën. Mandej dy raste janë të cilët punojnë në Administratën shtetërore, por atyre iu janë kërcënuar se nuk mund ta vazhdojnë punën.

Izmi Zeka- unë jam në ngjarje të kësaj problematike, por është i vështirë ndryshimi. Ne duhet të bëjmë rekomandime, por ky është standard evropian. Sipas këtij standardi së paku 10 vite duhet të jetë qytetarë i Kosovës çdo qytetarë që pretendon një nënshtetësi. Pesë vite ka qenë më parë, por tash është 10, por ju e dini se me dokumentacion të UNMIK-ut nënshtetësia i takon secilit, por nëse e arsyeton me letra, por nëse ka vetëm me fjalë është problematike, sepse nuk mund të arsyetohet. Ka plotë njerëz që deklarojnë se mbi 20 vjet jetojnë këtu, por dokument nuk posedojnë, prandaj shtrohet pyetja mbi çfarë bazë t' i epet dokumentacioni qytetarëve të tillë. Mirë është të bëhet rekomandimi, por për pa e kompletuar dokumentacionin është e pamundur të zgjidhet ky problem.

Ismet Hajdini- unë pajtohem me të gjithë diskutuesit, por e theksoi z. Zeka se këto janë ligje shtetërore dhe nuk mund të bëjmë dallime. Ne kemi shqiptar edhe nga Mali i Zi, kemi edhe nga Shqipëria dhe Maqedonia dhe kjo është çështje e pandarë. Gjithashtu duhet të jemi pak më realist dhe do të ishte mrekulli që t' i kthejmë të gjithë qytetarët në Bujanoc dhe Preshevë, por realiteti është se ne brenda Kosovës kemi shumë të shpërngulur, është Kosova Veriore nga ku çdo ditë po shpërngulen njerëzit, prandaj duhet t' i shikojmë gjërat më realisht. Mrekullia do të ishte nëse çdo kush kthehet aty ku ka qenë, por dëshira është diçka tjetër, kurse realiteti tjetër.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet kërkesa që t' i bëhet një rekomandim Qeverisë së Kosovës për t' i krijuar lehtësira në nxjerrje të dokumentacionit qytetarëve të Kosovës Lindore të cilët jetojnë në Gjilan.

Aprovohet ky rekomandim me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit

Të ndryshme

Valentinë Bunjku- Rexhepi- e kam bërë një lëshim, sepse na duhet ta aprovojmë edhe një subvencionim për KCIC e cila OJQ e ka dokumentacionin e kompletuar, prandaj duhet edhe këtë ta fusim në grupin e subvencionimeve. Mjetet financiare për këtë OJQ janë 5 mijë €, prandaj unë i lus anëtarët e Kuvendit që të aprovet kjo kërkesë dhe t' i bashkëngjitet vendimit të mëparshëm.

Izmi Zeka- mua po më habit një fakt, nëse nuk pat mjete për Beqir Musliun i cili për mua është një figurë e cila tërë kohën merr donacione të ndryshme. Unë nuk jam kundër kësaj, por ndihma kur të bëhet duhet zbatuar procedura, sepse kjo nuk ka kaluar në procedura.

Valentinë Bunjku- Rexhepi- procedurat janë zbatuar, por unë e kam bërë një lëshim dhe kam harruar ta propozoj në listën e subvencioneve, mandej shuma nuk është e madhe. Unë i lus anëtarët e Kuvendit që të votohet kjo dhe të inkorporohet në atë vendimin e mëhershëm.

Nevzad Isufi- zonja kryesuese po thotë se çështja e KCIC ka kaluar nëpër procedura, por në KPF kjo nuk ka qenë çështje debati. Kjo çështje nuk ka kaluar në KPF, por as nuk ka program konkret se çka parasheh kjo OJQ.?

Valentinë Bunjku- Rexhepi- kjo shoqatë e ka të mbyllur çështjen financiare e posedojmë raportin, prandaj kërkoj që edhe për këtë shoqatë që të hyjnë në pjesën e subvencioneve të pikës 2.2.

Sahit Abazi- unë propozoj që kjo të shtyhet për seancën e radhës, të zbatohen procedurat, të vijë materiali me kohë dhe pas procedurave askush nuk do të jetë kundër.

Ne nuk po themi që nuk e votojmë, por po themi të vijë materiali me kohë dhe ta kalojmë sipas procedurave normale.

Izmi Zeka- duhet lejuar Kuvendin të veprojë si të dëshirojë, por ju edhe nëse nuk zbatoni ligjin mund të ecni, sepse numrat i keni, por ne mund ta lëshojmë sallën dhe ju punoni, sepse nuk keni shumë kohë, ju kanë mbet edhe 2.5 vjet.

Ne njohim mirë këtë organizatë dhe i kemi ndihmuar disa herë, por shikoni materialet se a ka kaluar ndonjëherë në këtë formë apo jo?

Valentinë Bunjku- Rexhepi- pasi që nuk ka mirëkuptim kjo çështje të mbetet për seancën e radhës?

Leonorë Bunjaku- çështja për të cilën do të diskutoj ka të bëjë me trajnime. I nderuari drejtor në emër të shumë mësimitdhënësve e kemi një vërejtje përkitazi me trajnimet që po organizohen kohëve të fundit, sepse këto trajnime mbahen ashtu si trajnerëve iu përgjigjet, sepse organizohen gjatë vikendeve. Unë mendoj se me këtë lloj trajnimi në këtë mënyrë bëhet shkelje e të drejtave të njeriut, sepse dita e shtunë dhe e diel janë ditë pushimi dhe nuk është e lejuar të mbahen trajnime. Është fakt se plotë një muaj nxënësit kanë vijuar trajnimet duke filluar me MPLSH-në, korrikulin etj.

Unë sugjeroj që këto trajnime të organizohen pasi që të përfundojë mësimi dhe mos të malltretohen nxënësit gjatë vikendeve. Çështja tjetër ka të bëjë me trajnerët dhe për këtë pyes se kush i ka zgjedhur trajnerët? Kemi informatë se trajnerët të cilët e bëjnë trajnimin e korrikulës, ata nuk janë të trajnuar vetë për këtë proces. Si mund dikush të jetë trajner kur nuk e ka trajnimin e përfunduar për atë trajnim?

Pyetja tjetër është se Drejtoria e Arsimit sipas cilit Udhëzim administrativ mësimitdhënësve iu zbritet paga për arsyeje se kanë pasur mungesa në mësim, kurse nga drejtori i shkollës ato mungesa kanë qenë të arsyeshme? Kjo ka ndodhur në Gjimnaz, por edhe në shkolla të tjera.

Nevzad Rushiti- unë kam pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike, sepse në Komunën tonë ka filluar edhe ndërtim, por edhe rrënim i shumë objekteve, prandaj Drejtoria për Shërbime Publike

së bashku me atë DUMM duhet ta gjejnë një deponi për hedhje të mbeturinave të forta (materiale inerte). Për ta bërë këtë kërkesë më shtyri fakti se lumenjtë dhe disa lugina po mbushen me hedhurina dhe në këtë mënyrë po shëmtohet ambienti.

Ismet Hajdini- për materialet inerte është deponia regjionale dhe të gjithë operatorët dhe punë kryesit është e domosdoshme t' i dërgojnë në deponi për shtresim të materialeve inerte. Mirëpo operatorët për shkak të afërsisë dhe për shkak të harxhimeve më vogla i hedhin në afërsi të qyteti. Mirëpo kjo është punë e inspektorëve për shërbime Publike të cilët duhet të jenë në terren dhe të marrin masa ndëshkimore ndaj operatorëve të pandërgjegjshëm.

Sahit Abazi- unë propozoj që nga seanca e radhës ta kemi një konsideratë të cilët janë mjaft korrekt me Kuvendin siç është drejtori i Arsimit, ai i Shërbimeve Publike e të cilët gjithmonë qëndrojnë deri në fund të seancës, kurse disa drejtorë janë prezent në fillim të seancës, bëhen pyetjet, kurse në fund nuk janë të pranishëm për të dhënë përgjigje. Aktualisht në seancë janë vetëm tre drejtorë, por për ta lehtësuar këtë situatë, unë jam i interesuar që të kemi konsideratë për kohën të cilën duhet ta kenë drejtorët në mënyrë që të përgjigjen në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.

Unë propozoj që nga seanca e radhës pyetjet t' i bëjmë në fillim të seancës, të epen përgjigjet dhe pasi të shterret debati të fillojmë me rend të punës.

Nevzad Isufi- unë i bashkohem koleges për çështjen e trajnimeve e cila dukuri përpos që është shkelje e të drejtave njerëzore është edhe e kundërligjshme, sepse nuk lejohet që mësimdhënësve t' i merren dy ditë pushimi për muaj. Kjo është shumë e sigurt dhe nuk ka askush që e dëshmon të kundërtën. Unë e kam një pyetje e cila nuk ka të bëjë me drejtorët, por vlen për Prokurorimin, por vlen edhe për grupin e LDK-së se çka është çështje me shpallje të disa konkurseve përkatësisht tenderëve siç është çështja e udhëtimit të punëtorëve dhe të nxënësve me nevoja të veçanta. Një operator i tillë ka qenë desh të zgjidhet që disa muaj, kurse kësaj kategorie të nxënësve nuk i kompensohet udhëtimi në destinacionet e caktuara.

Po ashtu jemi në fund të muajit të 5 dhe ende nuk kemi tender për mirëmbajtje verore të rrugëve, kurse gjendja e rrugëve dihet se si është. Po ashtu më duket se po përsëritet gabimi i vitit të kaluar për dezinfektim dhe deratizim. Shtrohet pyetje se çka po ndodh me shpallje të tenderëve, sepse aq shumë ka humbur besimi sa që më nuk konkurron asnjë operator ekonomik. Si shembull i tillë është rregullimi i kompleksit të shkollave të mesme, sepse nuk është paraqitur asnjë operator. Unë mendoj se për shkak të moskorrektësisë nuk ka operator që konkurron për t' i kryer punët.

Duhet pasur kujdes dhe të mos lejohet që të kalojë sezoni verës dhe punët të mbesin të papërfunduara.

Jonuz Hasani- unë e kam një shqetësim i cili u potencua më parë e ajo është çështja e mbeturinave. Mirëpo si çështje tronditëse dhe mjaft shqetësuese është ajo e qenve endacak, sepse në çdo cep të lagjeve ka qen të grumbulluar e të cilët paraqesin rrezik për qytetarët. Ka informacione se qentë vijnë edhe nga komunat e tjera dhe koncentrohen në deponi të mbeturinave. Unë kërkoj që të jeni më vigjilent për këtë rast në mënyrë që të mos ndodh ndonjë rast tragjik.

Arijetë Rexhepi-pyetja e ime ka të bëjë me Drejtorinë e Urbanizmit e cila pyetja ka të bëjë lidhur me ndërtimin i cili po bëhet afër shkollës "Thimi Mitko", por edhe disa ndërtime të tjera.

Nga Drejtoria e Kadastrit e kam kërkuar listën e uzurpatorëve të pronës publike, por këtë listë ende nuk e kam marrë. Vërejtje tjetër është për inspektorët sanitarë, sepse nëpër shitoret tona kemi gjëra ushqimore me afat të skaduar, kurse ka raste edhe kur ka mish i cili kundërmon, kurse në tiketa figuron se gjëja ende ka afat për t' u përdorur!

Mandej kam vërejtje se zëvendësimi i anëtarëve të komiteteve bëhet në mënyrë automatike për pa u aprovuar në Kuvend, prandaj pyes se a paraqet kjo shkelje ligjore?

Krenare Latifi- Unë e kam një pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike anëtare e të cilit komitet jam dhe në këtë komitet në vazhdimësi është diskutuar për transportin urban, mirëpo konkretisht nuk është ndërmarrë asgjë deri më sot. Drejtori thotë se projekti i transportit urban është i gatshëm, mirëpo dëshiroj ta di se edhe sa duhet pritur për t' u zbatuar ai projekt?

Fehmi Sylejmani- unë pata pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike dhe drejtorin e Arsimit dhe besoj se ata i kanë marrë pyetjet dhe do të përgjigjen. Një rast tjetër të cilin e kam theksuar se në sektorin e tatimit në pronë çka është ndërmarrë për personat e hendikepuar, sepse ata nuk mund të shkojnë në katin e dytë?

Riad Rashiti- ne vazhdimisht po bëjmë pyetje, por nuk po marrim përgjigje, por edhe sot i kam disa pyetje, por nuk kam kujt t' i drejtohem, sepse drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe ai Urbanizmit nuk është prezent dhe nuk kam kujt t' i drejtohem në këtë seancë. Unë do të vazhdojë të bëj edhe më tutje pyetje me shkrim, kurse çështje tjetër do të jetë se a do të marrim përgjigje?

Mirëpo në këtë seancë po bëjë pyetje lidhur me Kosovatransin, sepse në këtë Bord ka një vit që një anëtar i ka kaur mandati, kurse konkursi ende nuk është shpallur, prandaj po pyes pse nuk është shpallur konkursi.

Pyetja e dytë është lidhur me panairin e Cyrihut ku ka qenë pjesëmarrëse edhe Komuna e Gjilanit, prandaj unë bëra pyetje se cilat projekte të Gjilanit janë prezantuar në këtë panair për mundësinë e investimeve në Gjilan. Sa kanë kushtuar shpenzimet për pjesëmarrje në këtë panair?

Pyetja tjetër ka të bëjë lidhur me projektin e Lumit Mirusha , sepse lidhur me këtë projekt nuk ka asnjë punë asnjë lëvizje dhe nuk dihet a është ndërprerë kontrata, apo është ndryshuar projekti, apo çka është duke ndodhur me këtë projekt?

Në fund kam pyetje për fondin e planifikuar për kompensim të vërshimeve dhe më intereson për ta ditur se a ka ndryshuar destinimi për t' shfrytëzuar ato mjete për projekte kapitale, apo çka po ndodh me këtë fond?

Valnetinë Bunjaku Rexhepi- pyetjet për Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik do të epen me shkrim, kurse sa i përket fondit për vërshime nuk është ndryshuar destinimi.

Nazmi Musa- drejtori i Arsimit u përgjigj në të gjitha pyetjet të cilat bën përkitazi me arsimin.

Sokol Haziri- gjithashtu edhe drejtori i Shërbimeve Publike u përgjigj në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit e të cilat i përkasin lëmisë së shërbimeve publike.

Fehmi Sylejmani – z. drejtor i Arsimit shumë qartë e thatë se duhet respektuar pragun kalues, por është mirë ta thoni shumë qartë se ky prag kalues do të jetë me planifikime të vjetra apo të reja, sepse është krijuar një konfuzitet lidhur me këtë prag.

Sa i përket orarit të trajnimeve që i përmendet po e theksoj se për korrikulën këtë vit vetëm dy ditë janë mbajtur këto trajnime në kohën e procesit mësimor. Këto trajnime duhet të mbahen gjatë qershorit dhe në muajin gusht pas datës 20. Sa i përket gjositjes për mësimdhënësit të cilët mungojnë në mësim, unë iu përgëzoj për këtë akt, sepse është koha dhe është ide e mirë.

Leonorë Bunjaku- kur është fjala për trajnime unë nuk e mora fjalën vetëm për thënë diçka, por është shumë e vërtetë se tërë një muaj disa mësimdhënës edhe të shtunën edhe të dielën kanë qenë në trajnim. Këto trajnime në këtë formë nuk bënë të mbahen, sepse unë e dhash e propozimin tjetër që këto trajnime të mbahen kur të përfundojë mësim një apo dy javë sa të ketë nevojë.

Nazmi Musa- z. Fehmiu e tha bukur se këto trajnime duhet të mbahen kur ne jemi në marrëdhënie pune dhe ne nuk punojmë. Të gjithë ata që janë në procesin mësimor e kam të qartë se kanë vështirë për t' i hartuar ato plan-programe, por nuk e kuptoj nëse mësimdhënësi ka vështirësi me plan-programin mësimor, ai 45 minuta është në orë, prandaj shtrohet pyetja se çka bën?

Nëse është në orë dhe nuk ka temë të caktuar, unë nuk e di si do të bëhen pyetjet ? Unë kam dyshime se mund të ketë mësimdhënës që mos të ketë plan-program mësimor për ta dorëzuar në drejtori. Pse nuk i bëhet vërejtja atij i cili thotë unë nuk dorëzoj plan! Ka raste kur arsimtari i thotë nxënësve ikni nga ora dhe në ditar shënohet se është humbur ora. Unë jam i sigurt se sikur t'i dinë prindërit se si sillemi ne në procesin mësimor do të kemi vërejtje shumë. Gjysmë vjetori i dytë për maturantët gjysma e kohës është e humbur, ju i keni fëmijët e juaj aty ata iu tregojnë. Punët duhet marrë seriozisht dhe mëditja do t'iu hiqet të gjithë atyre që janë të papërgjegjshëm në procesin mësimor, në të kundërtën më hiqmëni mua!

Me këto vendime dhe debate seanca IV (katërt) i përfundoi punimet në ora 16.30 min.

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesja e Kuvendit

Valentinë Bunjaku- Rexhepi